



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



MINISTRIA E BRENDSHME
SHOQËRIA “ILLYRIAN GUARD” SH.A.
DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ Prot

Tiranë më _____._____.2025

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mallra

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Uniforma”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

35811200-4 Uniforma Policie

18333000-2 Kemisha me meng

18211000-1 Pelerina

18234000-8 Pantallona

VLERA E FONDIT LIMIT: 158,297,370 (Njëqind e pesëdhjetë e tete milion e dyqind e nentëdhjetë e shtatë mijë e treqind e shtatëdhjetë) **LEK PA TVSH dhe 1,610,513.48(nje million e gjashtëqind e dhejtë mijë e pesëqind e trembedhjetë pik dyzet e tetë) Euro pa TVSH**

***Shenim :** Vlerat ne lek jan konvertuar ne monedhen euro me kursin zyrtar te kembimit te bankes se shqiperise me date 04.06.2025 me kurs kembimi 98.29 (nenetëdhjetë e tete pike snjezet e nente) leke

Në bazë të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, Ligji 16/2024 “Per disa shtesa dhe ndryshime ne ligjin Nr. 162/2020 “Per prokurimin publik” nenit 21, pika 2, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të autoriteti/enti kontraktor **Shoqëria “Illyrian Guard” ShA.**, VENDIM Nr. 291, datë 15.5.2024 ka hartuar procesverbalin për argumentimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Në zbatim të Urdhërit të Prokurimit Nr. Prot 605 ,datë 14.05.2025, të Administratorit, është ngritur Njësia e Prokurimit për hartimin e kriterëve të veçanta për procedurën me objekt: **“Uniforma”** për nevojat e shoqërisë “Illyrian Guard” Sh.A.

Në mbështetje të termave të references dhe fondit limit propozojmë kriteret e veçanta të kualifikimit si më poshtë vijon:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4.*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82, “Formulari përmbledhës i vetdeklarimet” dhe Nenit 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar.

Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” citohet: *“Autoriteti Kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Në Nenin 82, të LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetdeklarimet, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentacion që të provojë se plotëson:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Referuar pikës 1 të shtojcës 8, ofertuesi duhet të deklarojë se përmbush kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit. Këto kriteret duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.2 Kapacitetin ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2022, 2023 dhe 2024, ku vlera

e xhiros minimale vjetore, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 80% e vlerës së përlllogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure si dhe nenin 77, pika 3, të LPP (i ndryshuar), si dhe nenin 43, pika 2/a, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: dyfishin e vlerës së përlllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar. Kjo procedurë është mbi kufirin e lartë monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara si dhe është përcaktuar në atë masë / vlerë që të ruajë një balancë midis nxitjes së pjesëmarrjes dhe rritjes së konkurrencës si dhe nevojës që AK ka për tu siguruar që ofertuesit zotërojnë kapacitet e nevojshme në funksion të realizimit të kontratës.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku përcaktohet se: ”Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik dhe, sipas rastit të xhiros që mbulon kontrata, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare”, si dhe në legjislacionin e fushës në fuqi, përkatësisht në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. Kjo procedurë është mbi kufirin e ulët monetar dhe për këtë arsye, vlera e xhiros minimale të kërkuar, është brenda kufirit të parashikuar në dispozitat ligjore të sipërcituara.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të certifikuara të balanceve vjetore të 3 (tre) viteve të fundit financiare 2022, 2023 dhe 2024, të konfirmuara nga autoritetet përkatëse tatimore, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41/c të Ligjit Nr.10091, datë 05.03.2009 "Per Auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar.

Kjo kërkesë për kualifikim, konsiderohet e përmbushur nëse në 2 (dy) balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit. Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomikë, ky kusht plotësohet nga secili anëtar i bashkimit

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar).

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, është bërë bazuar në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998

"Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare".

Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga O.E vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma "c" të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar", i ndryshuar, ku parashikohet se: "Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël".

2.3 Kapacitetin Teknik:

2.3.1. Për të provuar përvojën e mëparshme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi për furnizime të mëparshme, të ngjashme, për një vlerë totale jo me pak se 40 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet, dhe që është realizuar gjatë 3 (tre) viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Këto furnizime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

1. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
2. për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, nenit 40/4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur brenda kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik dhe i shërben AK për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet, në vlerë jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat, me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme konsiderohet si kriter thelbësor dhe si rrjedhim operatorët ekonomikë

duhet të paraqesin dëshmi të tilla si: referenca/fatura tatimore, për të provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

2.3.2. Operatorët ekonomikë duhet të deklarojnë nëse janë **prodhues** apo **tregtues të autorizuar nga prodhuesit** për artikujt objekt prokurimi.

Në rast se ofertuesi nuk është prodhues duhet të paraqesë **autorizim nga prodhuesi/distributori i autorizuar** dhe të vërtetojë lidhjen midis tyre.

Operatori ekonomik ofertues në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provojë lidhjen ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (telefon, fax, e-mail, ëëbsite) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë lëshuar për objektin konkret të prokurimit dhe për llogari të autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe pikat 6 dhe 8, të nenit 40, të Rregullave të Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Autoriteti Kontraktor vlerëson se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave objekt kontrate, garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek Autoriteti Kontraktor të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet e kërkuara.

Konkretisht kjo kërkesë është vendosur :

1. për të rritur sigurinë dhe bindjen e AK se ofertuesit janë të aftë të realizojnë kontratën në rast se shpallen fitues si dhe
2. për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit.

Ky kriter është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike dhe i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së ofertuesve për përmbushjen me sukses të kontratës.

Autorizimi i prodhuesit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveçse tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se, ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet për besueshmërinë, cilësinë dhe kapacitetet e operatorëve ekonomikë ofertues. Në këtë kontekst, është domosdoshmërisht në dobi të përfituesve finale dhe produkteve/shërbimeve më cilësore, pra garanci për zbatimin me rigorozitet të furnizimit të mallit, si dhe për të garantuar AK se oferta teknike është e bazuar në produkte reale të identifikuar nga ofertuesit. Në këtë mënyrë provohet dhe aftësia reale e operatorit ekonomik për të realizuar kontratën në cilësi, sasi e kohë. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standardet apo prodhues të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë

së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale etj., reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Kjo kërkesë jep garanci më tepër për:

- Përfshirjen dhe suportin e prodhuesit, përmes rishitësit/partnerit të autorizuar.
- Vazhdimësinë dhe jetëgjatësinë e produktit
- Përmes regjistrimit të të dhënave të prodhuesit, përfitim të mëvonshëm potencial të suportit nga ana e tyre.

Gjithashtu, ky dokument siguron AK se:

a- Operatori ekonomik ka leje zyrtare nga prodhuesi ose distributori për të ofruar mallrat e tyre në tregun e Shqipërisë dhe se janë të autorizuar dhe të përshtatshëm për të ofruar këto mjete.

b- Nëpërmjet informacionit të plotë të prodhuesit, si numrat e telefonit, faksit, email-it, dhe faqes së internetit, AK ka mundësi të kontaktojë me prodhuesin për të verifikuar informacionin e ofruar nga operatori ekonomik. Kjo siguron se, çdo dyshim i mundshëm mbi autorizimin ose cilësinë e produkteve mund të adresohet me lehtësi dhe pa vonesë.

Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të kërkojë garanci mbi cilësinë e artikujve të sipërcituar, të njohë kapacitetet tekniko-profesionale të OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës, duke vërtetuar se disponojnë autorizimet përkatëse për furnizimin e produkteve.

Në përfundim, vendosja e kriterit për paraqitjen e autorizimit të prodhuesit ose distributorit është e arsyeshme dhe e nevojshme për garantimin e cilësisë, autorizimit dhe transparencës në këtë proces.

2.3.3. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tyre në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

1. Certifikatë **ISO 9001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të cilësisë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim;
2. Certifikatë **ISO 45001 - 2018** ose ekuivalente mbi “Sistemin e Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituar për këtë qëllim;
3. Certifikatë **ISO 14001:2015** ose ekuivalente mbi “Sistemet e menaxhimit të mjedisit”, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim.

Certifikatat si më sipër duhet të paraqiten origjinale ose kopje të noterizuara, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, standardet për shëndetin dhe sigurinë në punë dhe standardet e menaxhimit të mjedisit. Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin **79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”,** të ndryshuar dhe në nenin **44, të Rregullave të Prokurimit Publik,** miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të

dëshmojnë se plotësojnë standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit.

Për vetë natyrën dhe rëndësinë e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues të kontratës, të kryejnë veprimtarinë në përputhje me standartet e kërkuara të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe të mjedisit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve, reputacionit dhe besueshmërisë së operatorëve ekonomikë.

Konkretisht:

ISO 9001: është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërmarrjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërmarrje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërmarrjes në standartet e tregut. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001, me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të jenë në përmirësim të vazhdueshëm të proceseve dhe produkteve duke siguruar cilësi të qëndrueshme me çmime të favorshme.

ISO 45001: është standard ndërkombëtar, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001- me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 14001: ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operationet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. Autoriteti Kontraktor gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001: me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

2.3.4. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës, në funksion të përmbushjes me sukses të kontrates duhet të vërtetojnë se disponojnë personel të kualifikuar, si më poshtë :

1. Të pakten një Inxhinier tekstil
2. Të pakten një Modelist

Për sa më sipër operatorët ekonomike duhet të paraqesin :

Për inxhinierin tekstil:

Kopje të diplomës

Kontratën e punës;

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilin të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për peridudhën e kërkuar

Për punonjës in Modelist:

Dokument që të vërtetojnë kualifikimin profesional (dëshmi kualifikimi profesional/certifikate), lëshuar nga institucione (shtetërore apo private) të licensuara, sipas ligjit nr. 15/2017 "Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.

Kontratën e punës;

Kopje të librezës së punës;

Deklarimin e profilit të personelit të kërkuar në seksionin përkatës të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit;

Listapagesat sipas formularit E-Sig 025/a për periudhën e kërkuar

Personeli i kualifikuar duhet të jetë pjesë e përvijës së ofertuesit dhe për këtë OE duhet të dëshmojnë se kanë patur në listapagesat e shoqërisë për një periudhë jo më pak se tre muaj nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, specialistët e sipërcituar.

Shenim: Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9 të DST. Dokumentacioni provës do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afatëve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në **pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", të ndryshuar**, nenin 40, pika 5/b) dhe c), të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar dhe VKM nr. 514, datë 20.9.2017 "Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)", të rishikuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Për këtë është kërkuar që operatorët ekonomikë të vërtetojnë se për periudhën 3 muaj, kanë patur pjesë të stafit të tyre personel të kualifikuar, përkatësisht sipas kategorive të kërkuara. Kjo kërkesë synon të garantojë autoritetin kontraktor se kapacitetet njerëzore janë pjesë e përvijës së operatorit ekonomik ofertues dhe si të tilla rrisin sigurinë për të përmbushur dhe zbatuar kontratën objekt prokurimi brenda afatëve të parashikuara dhe në cilësinë e kërkuar.

Konkretisht kërkesa për inxhinierin e Tekstilit lidhet me përgjegjësinë e tij në **zhvillimin dhe menaxhimin e proceseve dhe produkteve në industrinë tekstile**. Inxhinieri i tekstilit përfshihet në të gjitha fazat e prodhimit të tekstileve, nga përpunimi i lëndëve të para deri te zhvillimi i produkteve të reja dhe përmirësimi i proceseve ekzistuese. Gjithashtu punojnë për të përmirësuar cilësinë, qëndrueshmërinë dhe efikasitetin e produkteve tekstile.

Inxhinieri i tekstilit mund të punojë në disa fusha, nga fabrikimi i pëlhurave dhe aksesoreve, duke përfshirë kërkimin dhe zhvillimin, prodhimin e veshjeve në të gjitha proceset, kontrollin e cilësisë dhe menaxhimin profesional. Ai mund të përcaktojë materialet e papërpunuara që duhen përdorur për të krijuar pëlhurat e duhura dhe të kontaktojë furnitorët për të koordinuar këto materiale. Gjithashtu, gjatë proceseve të prodhimit, ai mund të vëzhgojë dhe të koordinojë me teknikët për të identifikuar mënyra që i bëjnë operacionet më efikase.

Një inxhinier tekstili mund të implementojë dhe mbikëqyrë proceset e kontrollit të cilësisë dhe konformitetin e tyre me specifikimet teknike të kërkuara. Ai bashkëpunon me grupe të

tjera pune si shitësit, marketingun dhe grupin e shpërndarjes së mallit, duke i ndihmuar ata të kuptojnë veçoritë e produkteve të tekstit dhe si t'i prezantojnë ato tek klientët.

Kërkesa për Modelist lidhet me përzgjedhjen dhe përshtatjen e produkteve për prodhim. Ai është përgjegjës për koordinimin e çdo detaji dekorativ dhe funksional ndërmjet porositësit dhe prodhuesit, duke organizuar dhe shpjeguar materialet dhe aksesoret e duhur për realizimin në përputhje me standardet e cilësisë.

Modelisti është përgjegjës për porositjen e veshjeve, materialeve bazë dhe ndihmëse, duke ndihmuar kështu në zhvillimin dhe krijimin e një stili dhe dizajni tërheqës. Stilistët/modelistët janë gjithashtu përgjegjës për adaptimin e interesave të porositësit në stil, ngjyra dhe shije. Ata janë konsulentë dhe punojnë ngushtë me ekspertët dhe profesionistët e tjerë të sektorit kudo që lind nevoja. Ata konsultojnë dhe këshillojnë prodhuesin për çdo detaj teknik për realizimin e modeleve të kërkuara.

Janë personat përgjegjës për marrjen e masave trupore të klientit dhe përshtatjen profesionale të urdhrit të porosisë tek prodhuesi.

Diferenca midis një shoqërie që kontraktton punonjës rishtas pas fitimit të kontratës dhe një shoqërie që ka stafin e nevojshëm si pjesë të eksperiencës së saj lidhet kryesisht me nivelin e përgatitjes, efikasitetit dhe riskut të menaxhimit të projekteve.

2.3.5. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin nga 1 (një) model (mostër / produkt të gatshëm) të prodhuar për këtë procedurë prokurimi sipas kërkesave të specifikimeve teknike të kërkuara përfshi të gjitha detajet si lloji i materialit dhe pjesëve përbërëse të tyre, punimin, etj, për secilin nga artikujt objekt prokurimi pranë Autoritetit Kontraktor me adresë: “ Rruga Ibrahim Rugova, IshGarda e Republikës, Tiranë, Shqipëri”, Tiranë, në datën dhe orën e hapjes së ofertave. Mostrat e kërkuara më sipër, duhet të kenë një etiketë të qepur, e cila të përmbajë: mostër "emri i artikullit", datën e zhvillimit të tenderit, emrin dhe vulën e prodhuesit në etiketën e mostrës/ofertuesit.

a) Mostrat fizike të ndërtuara me lëndë të parë tekstil të jenë të shoqëruara me nga një pjesë 0,3 - 0,5 ml gjatësi lëndë të parë (tekstil sipas objekteve të uniformës) dhe sa gjerësia e vetë tekstit në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit. Të dyja anët e tekstit të jenë të mbyllura në anë (format të rregullt) dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike të tyre.

Shënim: Tekstili që shoqëron mostrën: Veshjet janë prodhuar prej pëlhure qoftë kjo e endur ose e thurur, e ngjyrosur me një bojë solide, e printuar. Përpara prodhimit të veshjeve Porositësi duhet të kryejë testime për të kontrolluar konformitetin e specifikimeve teknike të produktit. Për kryerjen e këtyre testimeve pranë Laboratorëve të Akredituar nevojiten 0.5 metra linear për tekstilet e endura edhe 0.3 metra linear për tekstilet e thurura.

b) Mostrat fizike me lëndë të parë lëkure të jenë shoqëruar nga një pjesë 30 x 30 cm lëkure në përputhje me specifikimet teknike të materialeve përbërëse të produktit dhe të shoqëruara me raporte testimi (Flete analizë) origjinale të lëshuar nga laboratorët të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi që kanë kryer analizën për karakteristikat (treguesit) fiziko- mekanike- kimike të tyre.

Mosparaqitja e mostrave sipas kërkesave të mësipërme përbën kusht skualifikimi për vazhdimin e procedurave.

c) Të gjitha detajet e mostrave (produkt të gatshëm) që do të paraqiten nga operatorët ekonomikë të jenë të qepura me penj dhe tegela të definuar si duhet pa fije të dala.

d) Mostrat e paraqitura duhet të kenë një etiketë, e cila të përmbajë: mostër “emri i artikullit” datën e zhvillimit të tenderit, emrin e prodhuesit/ofertuesit, nënshkrimin dhe vulën e operatorit ekonomik, të identifikueshme me numrin rendor përkatës në etiketë (sipas numrit rendor të artikujve objekt prokurimi).

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e mostrave si më sipër është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma a) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Autoriteti kontraktor ka gjykuar të arsyeshme paraqitjen e mostrave për artikujt objekt prokurimi dhe të lëndës së parë, të përcaktuara si më sipër, duke marrë në konsideratë sasinë e tyre, vlerën e fondit limit, llojin e mallit që kërkohet konkretisht specifikimet e ndryshme që ka secili artikull objekt prokurimi. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që të verifikohet përputhshmëria e specifikimeve teknike, duke garantuar që produktet e ofruara i përmbushin të gjitha kërkesat teknike dhe funksionale të përcaktuara në specifikimet teknike në dokumentat e tenderit. Kjo përfshin verifikimin e cilësisë së materialit të produktit final, dizenjimin e uniformave, dimensionet e kërkuara, si dhe karakteristika të tjera që lidhen me aksesoret që kanë këto artikuj, të cilat nuk mund të verifikohen përmes dokumentave të tjerë të kërkuara. Përfshirja e mostrave rrit transparencën dhe objektivitetin, duke i dhënë komisionit të vlerësimit një bazë të qartë për të krahasuar ofertat dhe për të marrë një vendim të drejtë. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit.

2.3.6. Operatorët ekonomikë ofertues duhet të paraqesin dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare (Raporte testimi / analiza) të materialeve përbërëse të produkteve, për të gjithë artikujt objekt prokurimi, të lëshuara nga institucione të autorizuar ose Laboratorë të akredituar sipas standarteve kombëtare/ ndërkombëtare në fuqi, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me Specifikimet teknike të kërkuara.

(Copa e përdorur për artikullin mostër, lëndëne parë që shoqëron atë dhe ajo që i bashkëngjitet fletë-analizës duhet të jenë detyrimisht të njëjta).

Argumentimi: Kërkesa e për paraqitjen e fletë analizave të lëndës së parë të përdorur nga prodhuesi është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 6, gërma c) dhe neni 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar; nenit 5 pika 1/a të ligjit Nr. 116/2014 “Për akreditimin e organeve të vlerësimit të konformitetit në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar, ku përcaktohet se: “Drejtorja e Përgjithshme e Akreditimit akrediton: a) laborator testues, mjekesor dhe kalibrues”, si dhe Rekomandimit të përbashkët nr.3330, datë 20.03.2028 të Agjencisë së Prokurimit Publik dhe nr.145, datë 16.03.2018 të Drejtorisë së Përgjithshme të Akreditimit “Rekomandim mbi hartimin e kërkesave të cilësisë”. Me anë të këtij kriteri, kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë për rezultatet e testimeve zyrtare (raport/fletë-analizës),

nëpërmjet të cilave duhet të vërtetojnë pajtueshmërinë e artikujve që ata ofrojnë me specifikimet teknike të objektit të prokurimit sipas vendimit të sipërcituar. Ky kriter është vendosur, gjithashtu duke iu referuar specifikimeve teknike ku verifikimi i disa elementeve të cilësisë së artikujve mund të verifikohet vetëm nëpërmjet analizave laboratorike për sa i përket lëndës së parë të përdorur për realizimin e produktit final. Fleta e analizës laboratorike garanton që materialet e përdorura për prodhimin e artikujve veshmbathje i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara, ku përfshihen lloji i lëndës së parë të përdorur dhe përbërësve të tjerë ndaj forcave mekanike, ujit, kimikateve apo faktorëve të tjerë që ndikojnë në performancën e produktit final. Fletë analizat sigurojnë që produkti përfundimtar do të jenë të qëndrueshme dhe të përshtatshme për përdorim afatgjatë. Siguria e përdoruesve të produktit përfundimtar, është një tjetër faktor që e bën të domosdoshme kërkesën për analiza laboratorike, duke i garantuar ata që produkti është i sigurt dhe mund të ofrojë mbrojtje adekuate daj rreziqeve të caktuara

2.3.7. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesincertifikatë OEKO-TEX “ose ekuivalente” për produktet tekstile (të lëshuar në emër të tij ose të prodhuesit, nëse ofertuesi nuk është prodhues), për të vërtetuar se produktet e ofruara nuk kanë substanca të dëmshme për shëndetin (përfshi lëndën e parë dhe aksesoret: pëlhurë, astar, frazelinat, kopsat, butona, penj, zinxhir, zbukurime etj) dhe janë në përputhje me normativat e specifikuara të OEKO-TEX ose ekuivalente.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 36 ,nenin 77, pika 1, shkronja “a” dhe nenin të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, në nenin 40 dhe 44 të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Çertifikata OEKO-TEX, është standardi që përfshin artikujt që kanë kontakt direkt me lëkurën. Standardi OEKO-TEX është në përputhshmëri me rregulloren e Bashkimit European që synon mbrojtjen e shëndetit të njeriut dhe mjedisit nga efektet e dëmshme të kimikateve (Registration, Evaluation, Authorisation and restriction of Chemicals - REACH), duke përfshirë kufizimet për substanca të caktuara të rrezikshme. Ky standart çertifikon produktet pasi janë të testuara për substanca të dëmshme duke siguruar që të jenë të sigurt për përdorim nga konsumatorët dhe për të mbrojtur shëndetin e njeriut dhe mjedisin nga rreziqet që mund të paraqesin kimikatet toksike. Çdo komponent i një produkti, që nga lënda e parë (metrazhi) e deri te aksesoret, duhet të jetë testuar rigorozisht kundër shumë kimikateve toksike. Qëllimi i çertifikatës është një praktikë miqësore me mjedisin dhe me përgjegjësi shoqërore që siguron një prodhim të qëndrueshëm, përfshirë etiketimin nga faza e prodhimit e deri në zinxhirin përfundimtar të furnizimit, ndërsa konsideron sigurinë e produktit tek përdoruesi përfundimtar. STANDARD 100 nga OEKO-TEX® është një nga etiketat më të njohura në botë për tekstilet e testuar për substanca të dëmshme. Ai garanton besimin e klientit dhe sigurinë e lartë të produktit. Nëse një artikull tekstili mban etiketën STANDARD 100, konfirmon se çdo përbërës i këtij artikulli, d.m.th. çdo fije, buton dhe pajisje të tjera, është testuar për substanca të dëmshme dhe se artikulli është i padëmshëm për shëndetin e njeriut. Testi kryhet nga institutet partnere të pavarura OEKO-TEX® në bazë të katalogut të gjerë të kriterëve OEKO-TEX®.

2.3.8. Operatorët ekonomikë për secilin nga artikujt e uniformës (referuar specifikimeve teknike) duhet të vërtetojnë se artikujt përputhen me kërkesat e përcaktuara nga standarti SSH/EN për veshjet/pajisjet mbrojtëse dhe janë të modeluar dhe prodhuar për të përmbushur kërkesat

thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016. Për këtë operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Certifikatën/at përkatëse sipas Direktivës 2016/425/EU ose e përditësuar, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë.

Argumentimi: Kjo kërkesë është vendosur për të vërtetuar pajtueshmërinë e produkteve të ofruara nga operatorët ekonomikë me standardet e Rregullores BE 2016/425, e cila ka për qëllim të sigurojë përdoruesit se produktet e ofruara janë të vlefshme, të besueshme, cilësore si dhe me transparencë në testimin dhe aftësitë e produktit.

Ky kriter është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe në nenin 44, të Rregullave të Prokurimit Publik, miratuar me VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar.

AK i është referuar një standardi ndërkombëtar, sikurse përcaktohet edhe në nenin 36 “Specifikimet teknike”, të LPP-së, “....dhe kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve apo përdorimin e produkteve”. Duke qenë se nuk ekziston një standard konkret kombëtar, pasi standardet e harmonizuara shqiptare të miratuara shërbejnë vetëm si dokumente me karakter referues për prezumimin e konformitetit të produktit dhe i referohen direktivës 2016/425/EU, AK i referohet rregullores së re 2016/425/EU me anë të së cilës aplikohet për procedurë verifikimi dhe certifikimi të shoqërisë prodhuese, ku vlerësohet se në modelimin apo prodhimin e këtyre artikujve respektojnë kërkesat thelbësore të përcaktuara në rregulloren 2016/425/EU, në të cilën përcaktohen kërkesat minimale që duhet të përmbajnë pajisjet mbrojtëse personale, në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë. Vendosja një kërkesë të tillë është në përputhje me kriteret e përcaktuara për të konfirmuar se, pas ekzaminimit dhe certifikimit të shoqërisë, artikujt e prodhuar prej tij nuk rrezikojnë shëndetin ose sigurinë e personave. (referuar rregullores). Kërkesa, që artikujt objekt prokurimi të përmbushin kërkesat thelbësore të shëndetit dhe sigurisë të përcaktuara me rregulloren EU nr. 425/2016 është vendosur pasi këto veshje janë prodhim për përdorim pune nga punonjës institucioni në shërbim komuniteti dhe mbrojtje të jetës (pra jo përdorim personal), të cilët përballen me situatat të ndryshme vështirësie, përfshirë kushtet atmosferike që nuk janë të një natyre ekstreme apo kontakti me sipërfaqe të nxehta që nuk i kalojnë 50 gradë Celsius (referuar kategorive të vështirësisë të përcaktuara në rregulloren EU nr. 425/2016). Gjithashtu, AK në specifikimet teknike të përgatitura nga specialistë të fushës janë vendosur edhe standardet SSH/EN për artikujt përkatës.

2.3.9. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin skeda teknike të tekstilit të përdorur për prodhimin e artikujve, të lëshuara nga prodhuesi i tekstilit dhe të pajisura me logon, kontaktet (telefon, email, faqe interneti), adresën, emër mbiemër dhe firmën e përfaqësuesit ligjor me vulën e kompanisë prodhuese të tekstilit.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur në përputhje me nenin 77 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe pikën 6/b, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Kjo është një kërkesë e domosdoshme për të vërtetuar përputhshmërinë e specifikimeve teknike të artikujve të ofertuara me specifikimet teknike të hartuara nga autoriteti kontraktor, për artikujt/ produktet që oferton.

2.3.10. OE duhet të lëshojnë një Deklaratë se artikujt objekt prokurimi do të kenë një afat garancie prej 1 (një) viti nga data e furnizimit të tyre, si dhe të garantohet AK se këta artikuj gjatë periudhës së garancisë nuk do të ndryshojnë karakteristikat e ngjyrës/ cilësisë sipas specifikimeve teknike, në të kundërt OE detyrohet ti zëvendësojë ato me artikuj të rinj.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, autoriteti kontraktor kërkon të sigurohet se, operatori ekonomik do të garantojë se mallrat e ofruara janë cilësore dhe sipas standarteve të kërkuara në dokumentet e tenderit, duke u bazuar në specifikat e punës që kryen personeli që do t'i përdorë, kushtet e punës, imazhin e autoritetit kontraktor. Në cdo rast operatori ekonomik duhet të mbajë përgjegjësi për mallat që ofron dhe se do t'i përgjigjet autoritetit kontraktor në rast se malli i furnizuar dëmtohet gjatë përdorimit për shkak të defekteve që vijnë si rrjedhojë e procesit teknologjik të lëndëve të para e ndihmëse që përdoren.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.